



03

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. 7739 prot.

Vlorë, më 19.05 .2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____. 2025

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DREJTUAR MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT PËR “PROGRAMIN E PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA”

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë;

VENDOSI

- I. Të miratojë deklaratën për bashkëfinancim drejtuar Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, në projektin “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese”.
- II. Të miratojë deklaratën për financimin e projekteve të përmirësimit të kushteve të 23 banesave ekzistuese për vitin 2025 në vlerën totale = 23 456 198 .12 lekë;
-në masën 40% të kostos së projektit nga buxheti i Bashkisë Vlorë = 9 382 479 . 25 lekë
- në masën 60% të kostos së projektit = 14 073 718. 9 lekë kërkohet bashkëfinancim nga buxheti i shtetit.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Vlorë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 20436/Prot.,

Vlorë, më 17.02.2025

Lënda: Deklaratë për bashkëfinancim për projektin “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese”.

DREJTORISË SË STREHIMIT

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Tiranë

Mbështetur në shkresën Nr. 15900Prot., datë 18.12.2024 “Mbi fondet për programet e strehimit 2025” të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Bashkia Vlorë aplikon për mbështetje buxhetore sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, në programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” në projektin “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese”.

Në këtë projekt për vitin 2025 janë përfshirë 23 familje/individë nga shtresat në nevojë që banojnë në lagje ekzistuese të qytetit të Vlorës, konkretisht në rajonet nr.1, nr.2, nr.4 dhe në katër njësi administrative, Njësia Administrative Qendër, me 1 banesë, Njësia Administrative Orikum me tre banesa, Njësia Administrative Novoselë me pesë banesa dhe Njësia Administrative Shushicë me gjashtë banesa.

Në buxhetin e vitit 2025 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.111, datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2025” në zërin e investimeve është parashikuar shuma prej 20.000.000 lekë për projektet e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara.

Nisur nga tabela nr.1 bashkëlidhur shkresës së lartpërmendur për „Nivelin e të ardhurave për frymë për çdo bashki për vitin 2023” dhe tabela nr.2 për „Kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit në varësi të nivelit të të ardhurave për frymë sipas tabelës nr.1”, Bashkia Vlorë do të financojë deri në 40% të kostos totale të projektit, duke kërkuar bashkëfinancim deri në 60% të kostos totale të projektit nga buxheti i shtetit. E shprehur në lekë,

-Kostoja totale për përmirësimin e kushteve të 23 banesave ekzistuese është = 23 187 764.09 lekë.

-Bashkia Vlorë deklaron se do të financojë vlerën = 9 275 105. 64 lekë.

-Kërkon nga buxheti i shtetit të bashkëfinancojë vlerën = 13 912 658.5 lekë.

SHQIPËRI
BASHKIA VLORE

Kjo deklaratë, ku pasqyrohet se Bashkia Vlorë do të financojë 40% të kostos totale për riparimin e 23 banesave në vlerën =9 275 105.64 lekë, duke kërkuar nga fondet e buxhetit të shtetit bashkëfinancim deri në 60% të kostos totale të projekteve në vlerën =13 912 658.5 lekë do të paraqitet për miratim në Këshillin e Bashkisë Vlorë në mbledhjen e radhës. Mbas miratimit do të dërgojmë kopje të Vendimit të Këshillit të Bashkisë pranë ministrit të suaj.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Për projektvendimin

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DREJTUAR MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT PËR “PROGRAMIN E PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PAFAVORIZUARA”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën Nr.15900 Prot., datë 18.12.2024 “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”, ka njoftuar të gjitha njësitë vendore mbi fondet e planifikuara për programet e strehimit për vitin 2025, duke i ftuar të aplikojnë për mbështetje buxhetore sipas ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar. Njoftimit për aplikim i bashkëlidhen “Termat e referencës për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitet 2025-2026”, që parashikojnë;

1. Llojet e projekteve që do të financohen nga buxheti i shtetit dhe kufijnjtë e financimit për familje,
2. Kushtet që duhet të plotësojë bashkia për t'u kualifikuar, formatin e aplikimit, dokumentacionin që do të hartohet për projektin, si dhe dokumentacionin që do të dorëzohet pranë ME, K&I për t'ju paraqitur Komisionit të Vlerësimit të Projekteve për shqyrtim dhe vlerësim (Dosja e aplikimit).

Pranë Bashkisë Vlorë përgjatë vitit 2024 janë regjistruar kërkesa nga familje/individë, të cilët disponojnë banesa të amortizuara në një ose më shumë pjesë të tyre, janë të papërshtatshme për banim të mëtejshëm, apo rrezikojnë jetën e banorëve nga mungesa e investimeve dhe e riparimeve ndër vite, për shkak të problematikave ekonomike dhe sociale të vazhdueshme. Po kështu janë depozituar shkresa nga njësitë administrative, Njësia Administrative Novoselë, për riparimin e banesave të disa familjeve në fshatrat Novoselë, Poro, Delisuf, Bishan, Trevllazër, Njësia Administrative Shushicë për riparimin e disa banesave në fshatrat Risili, Grabian, Mekat, Drithas, Njësia Administrative Orikum me shkresën për rikonstruksionin e banesave në Orikum dhe një në fshatin Tragjas.

Në projektet e këtij viti janë përfshirë 23 banesa me vendndodhje;

3 banesa në rajonin nr.4, 4 banesa në rajonin nr.1, 1 banesë në rajonin nr.2 , 1 në Nj.A.Qendër

3 në Nj.A.Orikum, 5 në Nj.A. Novoselë, 6 në Nj.A.Shushicë,

Grupet e punës të ngritura me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Vlorë kanë shkuar në të gjitha banesat, kanë evidentuar pjesët e amortizuara të tyre dhe në marrëveshje me familjarët kanë

përcaktuar ndërhyrjet dhe punimet më të domosdoshme që duhen kryer për përmirësimin e banesave të mbështetur në kufinj të financimit sipas termave të referencës me shkresën e ardhur nga ministria që mbulon strehimin. Në çdo banesë krahas matjeve planimetrike të nevojshme për të hartuar projekt-preventivat, janë bërë foto të pjesëve të dëmtuara të banesës në prani të familjarëve, të cilat do të jenë pjesë e dosjes së aplikimit që do të paraqitet pranë ministrisë.

Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 24.01.2025 mori në shqyrtim rezultatet e projekt-preventivave të hartuara për përmirësimin e 23 banesave, kostot për punimet e parashikuara sipas termave të referencës dhe kufijtë e e lejuar të financimit për çdo banesë në projektin e riparimit të kushteve fizike të banesave ekzistuese, si edhe vlerën e parashikuar në buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2025 në zërin e investimeve për këto projekte. U konkludua se;

Për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese për 23 familje/individë shuma totale e vlerave të të gjithë preventivave është = 23, 456, 198. 12 lekë me tvsh.

Ministria në Termat e Referencës ka përcaktuar edhe përqindjen e bashkëfinancimit që i takon të financojë çdo bashki nga buxheti i saj sipas pikës 7 të Udhëzimit të Ministrit nr.31, datë 18.11.2019, sipas nivelit të të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2023 të përcaktuar me tabelë.

Nisur nga tabela nr.2 për kufijtë e financimit sipas tabelës nr.1 „Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2023“, Bashkia Vlorë duhet të financojë deri në 40% të koston totale të projektit.

Komisioni përcaktoi se, Bashkia Vlorë duhet të financojë 40% të vlerës së projektit për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese = 9, 382, 479.25 lekë.

Deri në 60% të koston totale të projektit = 14, 073, 718.9 lekë do të kërkojë për bashkëfinancim nga buxheti i shtetit nëpërmjet Drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Pra, Bashkia Vlorë deklaron se do të financojë vlerën prej 9, 382, 479. 25 lekë të koston së projekteve.

Kërkon nga buxheti i shtetit për bashkëfinancim vlerën = 14, 073, 718. 9 lekë.

Deklarata për financim nga buxheti i Bashkisë Vlorë me vlerat përkatëse dhe kërkesa për bashkëfinancim nga buxheti i shtetit me vlerat përkatëse, duhet të miratohen në parim nga Këshilli i Bashkisë Vlorë dhe të përcillen pranë MEK&I si pjesë e dosjes së aplikimit.

Sa më lart, është hartuar ky projekt-vendim i paraqitur për miratim të këtij këshilli.

Konceptoi: D.Mustafai

Miratoi: Z.Selmani

Adresa: Sheshi "4Heronjtë", www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 2437 prot.

Vlorë, më 12.02.2025

MIRATOHET
KRYETAR

Ermal Dredha

VENDIM

Nr. 2, datë 24.01.2025

Për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Për programin përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 40, 41, 42, 43, të VKM Nr.454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, të shkresës së MEK&E Nr.15900 Prot., datë 18.12.2024 “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë i mbledhur në datën 24.01.2025, pasi shqyrtoi projekt-preventivat, kostot për punimet e parashikuara sipas termave të referencës dhe kufijtë e e lejuar të financimit për çdo banesë në projektin e riparimit të kushteve fizike të banesave ekzistuese, si edhe vlerat e parashikuara në projekt-buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2025 në zërin e investimeve,

KONSTATOI SE:

Në buxhetin e vitit 2025 të miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.111, datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2025” në zërin e investimeve është parashikuar shuma prej 20.000.000 lekë për projektet e përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese të komuniteteve të varfëra dhe të pafavorizuara. Shuma totale e preventivit për rikonstruksionin e 23 banesave është 23 187 764.09 lekë.

Nisur nga tabela nr.2 për kufijtë e financimit në varësi të nivelit të të ardhurave për frymë sipas tabelës nr.1 „Niveli i të ardhurave vjetore për frymë për çdo bashki për vitin 2023“, e përcaktuar në Termat e Referencës nga ministria që mbulon strehimin, Bashkia Vlorë duhet të financojë deri në 40% të koston totale të projektit.

Sa më lart komisioni,

VE ND O S I

1. Bashkia Vlorë për projektin e përmirësimit të kushteve fizike për 23 banesa të financojë 40% të vlerës = 9 275 105. 64 lekë.
2. Të kërkojë bashkëfinancim nga buxheti i shtetit 60% të vlerës = 13 912 658.5 lekë.
3. Lidhur me deklaratën për vlerën e financimit që merr përsipër të mbulojë Bashkia Vlorë dhe vlerën për bashkëfinancim që kërkohet nga buxheti i shtetit do të përgatitet projekt-vendimi që do të përcillet për të miratuar në Këshillin e Bashkisë. Vendimi i miratuar do të përcillet ministrisë si kusht i vendosur për kualifikim, pjesë e dokumentacionit që përmban dosja e aplikimit.

KOMISIONI

1. Irena Toshkallari
2. Zambak Selmani
3. Dorian Demiri
4. Skerdilajd Hunda
5. Orest Ruçaj
6. Manuela Prifti
7. Donald Leskaj

8. Bledar Toja
9. Kanan Shakaj
10. Genard Fegaj
11. Selim Haskoçelaj
12. Birçe Aliraj
13. Drita Mustafai